

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NADZOR  
Nr/Br. 582 / 19  
Datë/Datum. 10.09.2019  
PRISHTINË - PRIŠTINA

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:206-19-4445-1-1-1

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

PHARMA LEADER L.L.C  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Beqir Kastrati, Kom. Luledielli Obj. 4-4-1  
(Adresa)

Prishtinë  
(Vendi)

10000  
(Kodi postar)

+38345439855  
(Numri Telefonit)

/  
(Numri i Faks-it)

Gezim Kalaveshi  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Gezim.kalaveshi@pharma-leader.com  
(Adresa elektronike)

10.09.2019  
(Data e parashtrimit të ankesës)

Gezim Kalaveshi  
(Nënshkrimi dhe vlera)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimipër kontratë dt.:25.06.2019

Data e fundit e dorëzimit të ofertave:18.07.2019në14:00:00

Data e fundit e dorëzimit të ofertave: 05.09.2019 në 14:00:00

Kërkesa për rishqyrtim dt.:29.08.2019

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtimdt.:03.09.2019

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Nuk ka pas hapje të ofertave

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 27 i LPP-së  
Neni 18i RRUOPP  
Neni 26 i RRUOPP

*\*\* Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5.000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë rrejshme ose mashtruese.*

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Fillimisht ju rikujtojmë se ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale me nr. prokurimi 206-19-4445-1-1-1. Po ashtu kemi parashtruar edhe ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit për shkak të vendosjes së kriterëve favorizuese/diskriminuese. Ne kemi parashtruar ankesë për shkak se kriteri ka qenë i vendosur në këtë mënyrë:

**“Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi, ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar: “Autorizimi nga prodhuesi për tenderin përkatës (me të dhëna mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, web faqja etj. për mundësi të verifikimit) Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për vitin aktual dhe kërkohej të dorëzohet Original ose kopje e noterizuar”.**

Pas kësaj anekese, ne kemi kërkuar edhe një interpretim ligjor tek Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), ndërsa i njëjti institucion me dt.25.06.2019 ka lëshuar një interpretim si në vijim “Njoftimin për kontratë që keni në platformën elektronike ‘‘Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale’’ me nr. të prokurimit 206-19-4445-111 dhe nr. të brendshëm 206-19-36-111, ju lutem rishikoni edhe njëherë te Kapaciteti teknik dhe profesional ku keni kërkuar: Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi, në këtë rast Autoriteti Kontraktues është detyrues të kërkojë edhe nga dileri”.

Ne me datë 02.08.2019. e kemi pranuar njoftim për Korrigjimin e gabimeve, ku është shtuar edhe “Autorizimi nga Dileri” me të dhënat përkatëse, por me datë 26.08.2019.,

përsëri kemi marr njoftimin për korrigjimin e gabimeve ku është hequr fjalia "Autorizimi nga Dileri", gjë që është në kundërshtim me përgjigjen e KRPP-së.

Autoriteti kontraktues në fillim e ka marr për bazë interpretimin-sqarimin e KRPP-së në lidhje me këtë çështje, por pastaj ka marr vendim nëkundërshtim me sqarimin e KRPP-së.

Të nderuar, AK-ja tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionalenë nenin 9.1 & 9.2 në lidhje me Kapacitetin teknik dhe profesional ka kërkuar "Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi, ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar: . Autorizimi nga prodhuesi për tenderin përkatës (me të dhëna mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, ëb faqja etj. për mundësi të verifikimit) Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për vitin aktual dhe kërkohet të dorëzohet Original ose kopje e noterizuar.

Përsëri po ju njoftojmë se kjo kërkesë e autoritetit kontraktues është diskriminuese/favorizuese sepse favorizon operatorët ekonomik që janë të lidhur drejtpërdrejtë me prodhuesin, ndërsa diskriminon operatorë ekonomikë tjerë që mund të jenë autorizuar nga dileri apo operatorë ekonomik të rinj, prandaj kërkojmë nga ju që të detyroni autoritetin kontraktues që të respektoj interpretim-sqarimin e KRPP-së, dhe të hapet konkurrenca edhe njëherë dhe të ndryshohet kjo kërkesë me përmirësimin "Autorizim nga prodhuesi apo dileri"

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 27 të LPP-së dhe nenin 18.4 të RRUOPP, sepse nuk e ka përgatitur dosjen e tenderit mirë dhe në harmoni me qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa neni 18.4 i RRUOPP, shkruan qartë "Në dosjen e tenderit AK-ja do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjalë në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.

Gjithashtu neni 18.9 i RRUOPP-së përcakton qartë "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- ☐ Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- ☐ Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.

Ne me dt:03.09.2019 kemi marrë përgjigje nga ana e autoritetit kontraktues ku është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim të cilën autoriteti kontraktues e ka cilësuar si të pa bazuar dhe nuk ka dhënë ndonjë arsye faktike dhe ligjore për këtë vendim.

Duke u bazuar nëdispozitat e laartpërmendura dhe në kërkesën e AK-së, atëherë rezulton se me kërkesën që OE të ofrojnë dëshmi për autorizimin vetëm nga prodhuesi, kufizohet konkurrenca dhe favorizohen kompani të caktuara dhe njëkohësisht diskriminohen kompanitë tjera konkurruese.

Kërkesa e autoritetit kontraktues në lidhje me autorizimin është në kundërshtim edhe me nenin 7. Paragrafi 6 të LPP-sëku Shkruan: Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: (i) pjesëmarrjen samë të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur

meçmimindhelëndëneprokurimit; (ii) publikiminerregullt, dërgimindhe/ose disponueshmërinëetëgjithanjoftimeve, ftesave,informacionevehedokumentevegë kanë të bëjnë meaktivitetineprokurimitnëpërputhjeme këtëligj;(iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik;

Gjithashtu neni 26.4 i RRUOPP parasheh qartë që "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK-ja do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.

Prandaj autoriteti kontraktuesështë dashur të merr parasysh operatorët ekonomik të themeluar rishtazi me qëllim që të mos iu kufizohet konkurrenca.

Po ashtu me kërkesat e lartpërmendura mund të mos përmbushet qëllimi i këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa veprimet e autoritetit kontraktues mund të bien ndesh edhe me qëllimin e LPP-së, ku në nenin 1 të këtij ligji parashihet qartë që "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë".

Nëse veprohet më tutje me këto kërkesa dhe në këtë mënyrë, autoriteti kontraktues rrezikon seriozisht të dëmtojë buxhetin sepse në momentin kur kufizohet konkurrenca për prodhues të caktuar, atëherë mundësia është shumë e madhe që të ofrohen çmime shumë më të larta, se sa vlera e tregut, prandaj edhe rrezikohet të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të LPP-së dhe natyrisht cenohet edhe neni 6 i LPP-së.

Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që të merr:

#### VENDIM

**APROVOHET** ankesa si e bazuar e OE "PHARMA LEADER L.L.C

**DETYROHET** autoriteti kontraktues të ndryshojë kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, konkretisht të përmirësohet kërkesa në lidhje me autorizimin dhe të përcaktohet si në vijim "Autorizim nga prodhuesi apo dileri" dhe të veprohet konform nenit 53 të LPP-së. Në të kundërtën ne do të vazhdojmë me procedura tjera në instancat tjera kompetente.

#### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkëlja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Për momentin, nuk kemi llogaritur që kemi dëme materiale.

#### 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.